FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.122 24 nëntor 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9627 datë 30.10.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm dhe Shoqërisë "Mali", Gjakovë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur"……	4861
Ligj nr.9628 datë 30.10.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të SANT'EGIDIO-s për selinë dhe veprimtarinë e këtij Komuniteti në Shqipëri"….....	4862
Ligj nr.9629 datë 30.10.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për financimin e programit "Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit""…… ……	4866
Ligj nr.9630 datë 30.10.2006	Për faktoringun……	4878
Ligj nr.9631 datë 30.10.2006	Për artin skenik……	4885

LIGJ
Nr.9627, datë 30.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KOMITETI QEVERITAR I BISEDIMIT TË BORXHIT TË JASHTËM DHE SHOQËRISË "MALI", GJAKOVË, PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT TË PRAPAMBETUR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm dhe Shoqërisë "Mali", Gjakovë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5113, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KOMITETI QEVERITAR I BISEDIMIT TË BORXHIT TË JASHTËM, DHE KOMPANISË "MALI" GJAKOVË LIDHUR ME RISKEDULIMIN E BORXHIT TË PRAPAMBETUR

Marrëveshje, datë 1.9.2006, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Këshilli), i përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm (KQBBJ) dhe kompanisë "Mali" Gjakovë.

Neni 1

Subjekt i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i detyrimeve të prapambetura të "Kukësimpeks" Kukës, kundrejt kompanisë "Mali" Gjakovë, që rrjedhin nga transaksionet tregtare të realizuara gjatë vitit 1991.
Shuma e detyrimit arrin në 60 157,10 Clg.USD.

Neni 2

Të dyja Palët bien dakord që 1 Clg.USD të konvertohet në USD me kursin 1 Clg.USD = 1 USD.
Shuma e detyrimit për t'u paguar është 60 157,10 USD.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë angazhohet t'i paguajë kompanisë "Mali"

Gjakovë detyrimin prej 60 157.10 USD, me një këst të vetëm, menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Pagesat do të kryhen në llogarinë bankare që do të njoftohet me shkrim nga kompania "Mali" Gjakovë.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet pa rënien dakord me shkrim nga të dyja Palët.

Neni 5

Për çdo problem, Palët do të komunikojnë me njëra-tjetrën me shkrim në gjuhën shqipe, në adresat e mëposhtme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr.1
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 228405

LIGJ
Nr.9628, datë 30.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT TË SANT'EGIDIO-S PËR SELINË DHE VEPRIMTARINË E KËTIJ KOMUNITETI NË SHQIPËRI"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant'Egidio-s për selinë dhe veprimtarinë e këtij Komuniteti në Shqipëri".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5114, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT SANT'EGIDIO NË LIDHJE ME SELINË DHE AKTIVITETIN E KËTIJ KOMUNITETI NË SHQIPËRI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më tej referuar si Pala Shqiptare) dhe Komuniteti i Sant'Egidio, me seli qendrore në Romë (më tej referuar si Komuniteti):

duke njohur rëndësinë e veprimtarisë së organizatave dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter publik dhe privat në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me synimin për nxitjen e kulturës dhe pjesëmarrjes demokratike dhe solidaritetit ndërkombëtar;

duke marrë në konsideratë veprimtarinë disavjeçare të Komunitetit Sant'Egidio në rajone të ndryshme të botës për kryerjen e aktiviteteve me natyrë humanitare në shërbim të solidaritetit ndërkombëtar, e veçanërisht në fushën e shëndetësisë dhe të shërbimeve në dobi të njerëzve, si dhe për nxitjen e dialogut dhe bisedimeve ndërmjet Palëve për zgjidhjen paqësore të konflikteve në rajonin ballkanik;

duke vlerësur faktin që Komuniteti "Sant'Egidio" ka zhvilluar dhe zhvillon në territorin e Republikës së Shqipërisë një veprimtari të gjerë në fushën arsimore, shëndetësore dhe social-shëndetësore dhe vepron në funksion të zhvillimit demokratik dhe kulturor të popullatës në bashkëpunim me institucionet kompetente shqiptare,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1
Statusi i Komunitetit

Pala Shqiptare njeh natyrën ndërkombëtare të veprimtarisë së Komunitetit dhe respekton pavarësinë dhe paanshmërinë e këtij institucioni në aktivitetet që zhvillon në Republikën e Shqipërisë.

Komuniteti, përfaqësuesit dhe personeli i tij, në ushtrimin e aktivitetit të tyre në Republikën e Shqipërisë respektojnë dhe zhvillojnë funksionet e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar privilegjet e parashikuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

Neni 2
Bashkëpunimi i ndërsjellë

Palët angazhohen të nxisin bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet tyre, duke respektuar pavarësinë e veprimtarive në kuadër të solidaritetit, të zhvillimit, paqes dhe menaxhimit të projekteve me karakter social.

Neni 3
Selia e Komunitetit në Shqipëri

Selia qendrore e Komunitetit në Shqipëri ndodhet në Tiranë, rruga: "Fadil Rada", nr.78, tel/fax: 04 266122.

Komuniteti do të informojë me shkrim Ministrinë e Punëve të Jashtme për çdo ndryshim të mundshëm të selisë së tij qendrore.

Këshilli i kryesisë së Komunitetit e informon Ministrinë e Punëve të Jashtme për emrin e përgjegjësit të tij ligjor, i cili qëndron në këtë detyrë deri në një njoftim të dytë.

Për krijimin e selive të tjera, të cilat do të kenë të njëjta të drejta me selinë qendrore, sikurse parashikohet nga kjo Marrëveshje, pas miratimit nga Këshilli i Kryesisë së Komunitetit, është i nevojshëm miratimi i Palës Shqiptare, në bazë të kërkesës zyrtare të përfaqësuesit ligjor të Komunitetit.

Hapja e selive të tjera, që Komuniteti nuk do t'i gjykojë të arsyeshme të jenë të barasvlefshme me selinë qendrore, sikurse parashikohet nga kjo Marrëveshje, i nënshtrohen legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Pala Shqiptare angazhohet të marrë masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe qetësinë e selive të Komunitetit të parashikuara në këtë Marrëveshje, po ashtu dinjitetin e mjedisit rrethues, duke marrë në konsideratë ruajtje të veçantë që i kërkohet Palës Shqiptare nga Komuniteti po të jetë e nevojshme, si dhe dinjitetin e fasadës së selisë qendrore.

Neni 4

Imuniteti i selisë dhe arkivave të Komunitetit

Lokalet e selisë qendrore të Komunitetit janë të pacenueshme. Përfaqësuesit e shtetit shqiptar nuk mund të hyjnë në ambientet e selisë për të ushtruar funksionet e tyre pa miratimin paraprak të përfaqësuesit të Komunitetit në Shqipëri.

Përfaqësuesi i Komunitetit në Shqipëri detyrohet t'i përgjigjet çdo kërkese të autoriteteve shqiptare, brenda një periudhe të shpejtë kohe.

Miratimi i përfaqësuesit të Komunitetit për të hyrë në selinë qendrore të Komunitetit do të konsiderohet i dhënë, në rast fatkeqësish natyrore, rënie zjarri etj., si dhe në rastet kur ka të dhëna të besueshme për veprime kriminale në këto ambiente, në bazë të vendimit të organeve kompetente shtetërore. Kopja e këtij vendimi do t'i dorëzohet paraprakisht përgjegjësit ligjor të Komunitetit. Vetëm në raste veçanërisht të ngutshme, ky dokument mund të dorëzohet menjëherë pas ndërhyrjes së organeve përkatëse.

Arkivat e Komunitetit dhe në përgjithësi të gjitha dokumentet që i përkasin ose që mbahen prej tij janë të padhunueshme kudo që të ndodhen. Sido që të jetë, shqyrtimi i dokumenteve do të mundësohet nga përgjegjësi ligjor, pas kërkesës që do të bëhet nga ana e organit shtetëror përkatës. Përjashtim bëhet vetëm në rastet kur, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në bazë të vendimeve të organeve kompetente shtetërore, është i nevojshëm shqyrtimi i dokumenteve zyrtare të Komunitetit.

Neni 5

Hyrja, qëndrimi dhe dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë

Autoritetet shqiptare angazhohen të marrin masat e nevojshme me qëllim lehtësimin e hyrjes, qëndrimit dhe daljes së anëtarëve të huaj të Komunitetit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Autoritetet diplomatike dhe konsullore shqiptare të akredituara në shtetet e tjera do të trajtojnë me përparësi, në respektim të legjislacionit në fuqi, kërkesat për pajisje me vizë hyrjeje të anëtarëve të Komunitetit. Për këtë qëllim, Komuniteti do të njoftojë paraprakisht me shkrim Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Autoritetet shqiptare, në bazë të kërkesave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të shqyrtojnë kërkesat për pajisje me leje qëndrimi të anëtarëve të Komunitetit.

Pala Shqiptare angazhohet për shpejtësinë e sigurinë e procedurës së lëshimit të vizës dhe, njëkohësisht, ruan të drejtën e moslëshimit të vizës.

Vizat e hyrjes, të lëshuara anëtarëve të Komunitetit, janë pa pagesë.

Neni 6

Përjashtime nga taksat doganore

Të gjitha importimet e realizuara nga Komuniteti, në kuadrin e programeve dhe veprimtarisë humanitare që ushtron në Shqipëri, do t'u nënshtrohen përjashtimeve nga taksat doganore dhe detyrimeve të tjera në import, sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

Në rastet kur donatori nuk pranon të financojë pagimin e TVSH-së apo kostos lokale, ato financohen nga përfituesi apo investitori vendas i projektit dhe paguhen nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit.

Komuniteti ka të drejtë të importojë sendet për përdorim zyrtar, duke qenë i përjashtuar nga taksat doganore dhe çdo detyrim fiskal, që nga çasti i hyrjes së tyre në territorin shqiptar.

Neni 7

Përdorimi i përkohshëm i ambienteve pa pagesë

Me kërkesë të Komunitetit, autoritetet shqiptare, brenda mundësive fizike dhe financiare, autorizojnë përdorimin e përkohshëm të ambienteve të ndryshme publike për aktivitete të caktuara të Komunitetit në funksion të veprimtarisë së saj, pa pagesë.

Neni 8
Ndihma e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, brenda mundësive të tyre dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe të vendit ku janë të akredituara, do të japin ndihmën e tyre në situata emergjente për anëtarët e Komunitetit që ndodhen në shtetet ku janë të akredituara.

Neni 9
Dokumenti i emërimit në detyrë

Komuniteti do t'i pajisë anëtarët e tij, me shtetësi të huaj ose shqiptare, me një dokument me fotografi të quajtur "Dokumenti i emërimit në detyrë", që vërteton identitetin e mbajtësit dhe statusin e tij/saj si anëtar i personelit të Komunitetit.

Pala Shqiptare mund t'i kërkojë Komunitetit t'ia dorëzojë listën e personave që kanë të drejtë ta mbajnë këtë dokument.

Neni 10
Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje

Kushtet e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen në çdo kohë me marrëveshje ndërmjet Palëve.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi datën e marrjes nga Komuniteti të njoftimit zyrtar të Palës Shqiptare për plotësimin e kërkesave të nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj.

Neni 12
Përfundimi

Kjo Marrëveshje mund të përfundojë me kërkesën me shkrim të njërës prej Palëve, me një paralajmërim paraprak prej 6 muajsh, pas të cilit efekti i kësaj Marrëveshjeje merr fund.

Neni 13
Origjinalet

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe atë italiane, ku të dyja kopjet do të jenë të barasvlefshme.

Bërë në Tiranë, më 3.8.2006.

LIGJ
Nr.9629, datë 30.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT "REHABILITIMI I RRUGËS SHKODËR-HANI I HOTIT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për financimin e programit “Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5115, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
(Më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese")

Për realizimin e Programit "Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit",
duke pasur parasysh:
se në protokollin trevjeçar të bashkëpunimit 2002-2004, Qeveria Italiane ka marrë përsipër të financojë një iniciativë për rehabilitimin e rrugës ekzistuese Shkodër-Hani i Hotit dhe për përmirësimin e funksionimit të tij, duke dhënë për këtë qëllim ndihmë prej 21 700 000,00 euro kredi dhe prej 150 000,00 euro grant;
se gjatë mbledhjes së datës 20 dhjetor 2005, Komiteti Drejtues i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) ka dhënë pëlqimin për dhënien e një ndihme prej 21.700.000,00 euro kredi dhe prej 150 000,00 euro grant, për realizimin e ndërhyrjes "Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit" më poshtë i quajtur Programi;
në lidhje me sa më sipër,
Palët Kontraktuese janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1
Qëllimi dhe pjesët përbërëse të Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë detyrimet e ndërsjella të të dyja Palëve Kontraktuese për zbatimin sa më korrekt të Programit, duke iu referuar në mënyrë të veçantë procedurave të vlerësimit të kontratave, si dhe të procedurave të menaxhimit / prejardhjes / livrimit të fondeve të kredisë së ndihmës.
Kjo Marrëveshje përbëhet nga 15 nene dhe nga 3 shtojca bashkëngjitur, të renditura më poshtë, që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje:
1. përmbledhja e Programit;
2. tenderat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve (kushtet e veçanta);
3. mënyrat e zbatimit dhe të administrimit të kredisë së ndihmës.
Fjalët dhe shkurtesat e përmendura në tekst kanë kuptimet e mëposhtme:

SHKURTIME

Marrëveshja -Marrëveshja aktuale ndërmjet Palëve për zbatimin e Programit.

Ambasada Italiane - Ambasada e Italisë në Tiranë.

Marrëveshja financiare - Marrëveshja ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Financave dhe Drejtuesit të Fondit Rotativ Italian.

Donatori - Qeveria Italiane

Donacioni - Fondi i vënë në dispozicion nga DPBZH-ja për zbatimin e disa komponentëve të Programit.

Linja e kredisë - Kredia në fjalë e ndihmës për financimin e veprimtarisë së parashikuar në këtë Program dhe e rregulluar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Palët - Ministria e Punëve të Jashtme Italiane - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve).

MPJ-DPBZH - Ministria e Punëve të Jashtme Italiane - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim.

MPPTT - Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve.

MF - Ministria Shqiptare e Financave.

NJZP - Njësia e Zbatimit të Projektit e ngritur pranë MPPTT, që do të kujdeset për koordinimin e funksioneve, me natyrë teknike e drejtuese, të nevojshme për realizimin e Programit.

Programi - Tërësia e ndërhyrjeve të parashikuara e të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

NJQT - Njësia Teknike Qendrore e MPJ – DPBZH.

NJTL - Njësia Teknike Lokale (zyra e bashkëpunimit) e Ambasadës Italiane në Tiranë.

Neni 2

Objektivat e Programit

Objektivi i përgjithshëm i Programit është të kontribuojë në intensifikimin e shkëmbimeve tregtare me Malin e Zi, gjithë zonën e Ballkanit dhe Europës, si dhe për të përmirësuar rrjetin rrugor midis zonës së Shkodrës dhe zonave më të pasura dhe të zhvilluara të Shqipërisë.

Objektivat specifikë të Programit janë: - të zvogëlojë kostot operative të transportit mbi rrota; - të zvogëlojë kohën e nevojshme të përshkimit të këtyre distancave; - të zvogëlojë përqindjen e lartë të aksidenteve; - të shtojë kujdesin e infrastrukturës së rrugëve shqiptare; - të favorizojë zhvillimin ekonomik të veriut të Shqipërisë dhe raportet me Malin e Zi.

Neni 3

Përshkrimi i Programit

Programi përshkruhet shkurtimisht në shtojcën 1 dhe propozon arritjen e rezultateve të mëposhtme:

- Realizimin e përshtatjes të rreth 43 km rrugë (34 km ndërurbane dhe rreth 10 km të kuadrit urban) me një seksion të ri rrugor i ngjashëm me kategorinë italiane F, e përshtatshme për flukset e tanishme të trafikut dhe për ato që parashikohen për një periudhë afatmesme (2010) e afatgjatë (2020);

- Rimëkëmbjen dhe/ose rindërtimin e veprave të artit (ura, mbyllës shtonesh etj.) mjaft të degraduara, me një sipërfaqe të menduar si kurriz qemeri për urat dhe veprat kryesore me rreth 4.000 m^2;

- Realizimin e infrastrukturës rrugore në përputhje me standardet europiane dhe normat teknike në këtë fushë në lidhje me ngarkesat, sigurinë, sinjalistikën;

- Përmirësimin e cilësisë urbane të qendrave kryesore të përshkuara (Shkodër, Koplik dhe Bajzë) duke parashikuar vepra urbane të munguara, në mbrojtje të shfrytëzuesve më të dobët të rrugës (drenazhime, ndriçime, trotuare etj.);

- Respektimin e kushteve cilësore, ekonomike e kohore të Projektit.

Zbatimi i Programit kërkon:

- projektimin paraprak, përfundimet dhe SIA të rrugës Shkodër-Hani i Hotit;

- drejtimin e punimeve të rrugës Shkodër-Hani i Hotit;

- punime për përshtatjen e rrugës Shkodër-Hani i Hotit.

Neni 4

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit janë si më poshtë:

Për Palën Italiane:

a) MPJ/DPBZH (Ministria e Punëve të Jashtme/Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim), e cila do të sigurojë livrimin e burimeve financiare për kredinë sipas modaliteteve të parashikuara nga dispozitat ligjore italiane në fuqi, të treguara në mënyrë të përmbledhur në këtë Marrëveshje. MPJ/DPBZH, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), do të ketë, përveç të tjerash, edhe detyrën për të monitoruar ecurinë e Programit dhe mundësinë e tij për të arritur rezultatet e caktuara në nenin 3. MPJ/DPBZH do të veprojë nëpërmjet zyrave kompetente për zbatimin e detyrave të saj. Në veçanti, njësia teknike qendrore e MPJ/DPBZH-së më poshtë e quajtur NJTQ, do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike në mbështetje të realizimit të Programit.

b) Artigiancassa, e cila - nën drejtimin e MPJ/DPBZH-së dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane-do të nënshkruajë me Ministrinë e Financave të Shqipërisë (MF), një Marrëveshje financiare, që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës. Në kuadrin e Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, Artigiancassa do të kujdeset për zbatimin e kontratave të veçanta për livrimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program. Ajo do të merret gjithashtu edhe me sigurimin e pagesave të shumave të kontratave të organizmave zbatues.

c) Ambasada/NJTQ në Tiranë, e cila do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike të nevojshme për sigurimin e ecurisë korrekte të veprimtarive. Në kuadër të funksioneve të veta institucionale, Ambasada/NJTQ do të sigurojë kontaktet e nevojshme me palët e Programit, duke u kujdesur ndër të tjera për marrjen dhe përcjelljen e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Për Palën Shqiptare:

a) MPPTT, e cila do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që dalin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe strukturat e tjera kompetente shqiptare;

b) MF, e cila do të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me Artigiancassa-n dhe do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit, ashtu siç është saktësuar në Marrëveshjen financiare;

c) banka vepruese në Shqipëri që do të mbajë kontaktet e punës me Artigiancassa-n dhe funksionet e përshkruara në shtojcën 3 pjesa III, pika 3 dhe 4;

d) NJZP e ngritur pranë MPPTT-së, e cila do të merret me koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe drejtuese të nevojshme për realizimin e Programit.

Neni 5

Burimet financiare dhe modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit janë si më poshtë:

1. Kredi ndihme në shumën prej 21 700 000 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program;

2. Fond grant prej 150 000 euro për:

- veprimtaritë e redaktimit të termave të referencës për përzgjedhjen e shoqërisë italiane të konsulencës, së cilës do t'i besohen shërbimet e inxhinierisë (Projekti ekzekutiv dhe supervizioni i punimeve);

- monitorimin e veprimtarive gjatë zbatimit të veprës.

Kredia e ndihmës do të livrohet me të tilla kushte financiare, ku të parashikohet një taksë lëshimi (grant element) të paktën jo më e ulët se 80.26%.

- Afatet dhe kushtet e kredisë së ndihmës do të jenë:

- Periudha e rimbursimit të kredisë: 39 vjet;

- Periudha e faljes (pa pagesë principiali): 19 vjet;
- Taksa vjetore e interesit: 0.00%.

Në bazë të procedurave në fuqi pranë MPJ-DPBZH-së, hapat kryesorë për t'u ndjekur në përdorimin e kredisë së ndihmës (të specifikuara më mirë në shtojcën 3) janë si më poshtë:

1. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Projektit (mbi bazën e kësaj skice), që përmbledh brendinë e propozimit të financimit, cakton detyrimet e Palëve në realizimin e ndërhyrjes dhe ndjekjen e veprimeve përkatëse.

2. Nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane të një dekreti ministror, që autorizon Artigiancassa-n për të negociuar dhe firmosur kontratën financiare me MF-në.

3. Firmosja e kontratës financiare ndërmjet ARTIGIANCASSA dhe MF-së.

4. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit për porositjen e shërbimeve inxhinierike (projektim e drejtim punimesh), nga ana e NJZP-së kompetente pranë ministrisë shqiptare të linjës dhe me mbështetjen e DPBZH-së.

5. Verifikimi nga ana e MPJ-DPBZH-së i konformitetit të dokumentacionit të mësipërm në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe në rast rezultati pozitiv, shpallja e tenderit me një publikim të njëkohshëm të njoftimit në Itali (në ngarkim të MPJ-DPBZH-së) dhe në Shqipëri.

6. Vlerësimi i ofertave të ardhura, nga komisioni i ngritur nga ministria shqiptare kompetente dhe dhënia e porosive, me klauzolë pezullimi.

7. Verifikimi nga ana e MPJ-DPBZH-së i konformitetit të procedurës së ndjekur të seleksionimit dhe të kontratës që do të lidhet, dhe në rast rezultati pozitiv, lidhja e kontratës nga ana e ministrisë kompetente shqiptare.

8. Në përfundim të veprimtarisë projektuese, verifikimi nga ana e MPJ-DPBZH i dokumentacionit të tenderit për punimet dhe në rast rezultati pozitiv, shpallja e tenderit nga ana e ministrisë kompetente shqiptare me një publikim të njëkohshëm të njoftimit në Itali (në ngarkim të MPJ-DPBZH-së) dhe në Shqipëri.

9. Vlerësimi i ofertave nga komisioni i ngritur nga ministria shqiptare kompetente dhe dhënia e sipërmarrjes së punimeve, me klauzolë pezullimi.

10. Verifikimi nga ana e MPJ-DPBZH i konformitetit të procedurës së ndjekur të seleksionimit dhe të kontratës që do të lidhet, dhe në rast rezultati pozitiv, lidhja e kontratës për punimet nga ana e ministrisë kompetente shqiptare.

11. Ngarkimi me përgjegjësi i kontratave të veçanta, të lidhura dorë pas dore, sipas Marrëveshjes financiare.

Kontratat e miratuara nga MPJ-DPBZH-ja do të jenë në ngarkim të Marrëveshjes financiare me modalitetet e livrimit të fondeve të treguara në shtojcën 3.

Neni 6

Monitorimi i Programit

Ecuria e Programit do të monitorohet bashkërisht nga MPJ-DPBZH-ja (përmes misioneve periodike të funksionarëve dhe ekspertëve të caktuar sipas nevojës) dhe nga MPPTT-së. Të dyja Palët angazhohen që tani të përcaktojnë të gjitha masat që do të shihen të nevojshme në rast se, gjatë zbatimit të Programit, skema e treguesve nuk do të respektohet apo nuk do të konsiderohet më e përshtatshme për kushtet sektoriale dhe lokale.

Neni 7

Modalitetet e përfitimit të shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve

Përcaktimi i zbatuesve të veprimtarive të Programit do të kryhet përmes hapjes së tenderave të disiplinuara nga dispozitat që përmban manuali i procedurave (i përshtatur nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002) dhe ndryshimet e mundshme të bëra më pas, me përjashtim të pjesës që i përket rregullave mbi kombësinë dhe origjinën, e cila do të adoptohet sipas veçantisë së kredisë italiane ndihmëse, në lidhje me: "Tenderat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta", si edhe nga sa është përcaktuar në shtojcën 2.

Neni 8
Detyrimet e Qeverisë Italiane

Qeveria Italiane merr përsipër të garantojë financimin:

- deri në 21.700.000 euro, si kredi ndihme, që do të bëhet i disponueshëm pranë Artigiancassa-s dhe do të livrohet siç është përcaktuar në shtojcën 3;

- deri në 150.000 euro, në formë granti, që do të menaxhohet direkt nga MPJ/DPBZH, si dhe nga ambasada/NJTQ.

Neni 9
Detyrimet e Qeverisë Shqiptare

Qeveria Shqiptare merr përsipër:

- të vërë në dispozicion burimet financiare që ka në kompetencë, të barazvlefshme me 4.500.000 euro ose monedhë të ngjashme;

- të ndërmarrë të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet formale të domosdoshme për zbatimin me sukses të Programit;

- të bashkëpunojë me MPJ/DPBZH për veprimtaritë e monitorimit të Programit, sipas nenit 6, dhe për krijimin e aksesit në dokumentacionin ekzistues dhe në zonat e veprimtarisë.

Neni 10
Dispozitë antikorrupsion

Qeveria Italine është impenjuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format që ai mund të shfaqet. Në veçanti, me qëllim që të shmanget çdo rast veprimtarie e paligjshme apo parregullsie në rastet e prezantimit të ofertave për furnizime, shërbime dhe veprave ndërtimore, Qeveria Italiane ka futur, për të gjithë pjesëmarrësit në tender, detyrimin e nënshkrimit dhe të paraqitjes së një pakti integriteti (*Integrity Pact*), bashkëngjitur me ofertat e tyre apo kontratat e miratuara. Mungesa e paraqitjes së këtij pakti integriteti do të sjellë përjashtimin në mënyrë automatike nga tenderi dhe mungesa e respektimit të tij gjatë zbatimit të kontratës së miratuar do të sjellë zbatimin e sanksioneve të rëndësishme, të parashikuara në të. Futja e kësaj dispozite ka për qëllim sigurimin e një konkurrence korrekte dhe mundësive të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në tender, si dhe një zbatim korrekt dhe transparent të kontrarës së miratuar.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis Palëve Kontraktuese lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet, për aq sa është e mundur, nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 12
Pengesat dhe forca madhore

Në rast të pengimit të realizimit të Programit për shkak të forcave madhore (luftë, përmbytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikte pune, greva, masa qeveritare, vështirësi të paparashikuara në transport dhe shkaqe të tjera) të pranuara nga të dyja Palët ose në rast rreziku apo kushte të rrezikshme për personelin e huaj, do të zbatohen dispozitat në vijim, të bazuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe të miratuara nga MPJ/DPBZH-ja.

a) Në rast se kohëzgjatja e pengimit të realizimit të Programit është më pak se 6 (gjashtë) muaj, përdorimi i fondeve të papërdorura do të pezullohet derisa MPJ/DPBZH-ja të autorizojë rifillimin e veprimtarive.

b) Në rast se kohëzgjatja e pengesës është më shumë se 6 (gjashtë) muaj dhe më pak se 24 (njëzet e katër) muaj, Programi pezullohet dhe fondet e papërdorura do të mbahen derisa të mos ketë më pengesa dhe të merret autorizimi i MPJ/DPBZH-së për rifillimin e punimeve.

c) Në rast se kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se 24 (njëzet e katër) muaj, Palët duhet

të bien dakord për vazhdimësinë e Programit dhe të përcaktojnë rrjedhën e veprimeve. Në rast se është i pamundur vazhdimi i veprimtarisë, Palët duhet të vendosin për destinacionin e fondeve të papërdorura.

Neni 13
E drejta e zgjidhjes së Marrëveshjes së MPJ/DPBZH-së

MPJ/DPBZH-ja ruan të drejtën e tërheqjes nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

a) mosrealizimi i veprimtarive të parashikuara në Program për arsye që nuk kanë të bëjnë me Palën Italiane;

b) pengesa të vazhdueshme ose forca madhore në bazë të nenit 12, si më sipër;

Në të dyja rastet e sipërpërmendura, MPJ/DPBZH-ja mund të vendosë unanimisht përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar MPPTT-në dhe MF-në përmes një note verbale të paktën 3 muaj përpara. Në çdo rast, pas një njoftimi të tillë, MPPTT-ja do të ndërpresë veprimtarinë e Programit, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 14
Ndryshimet

Palët mund të propozojnë ndryshime të përmbajtajes së kësaj Marrëveshjeje me anë të shkëmbimit të notave verbale nëpërmjet rrugëve diplomatike. Ndryshimet apo shtesat e bëra në këtë mënyrë dhe të rëna dakord ndërmjet Palëve, do të hyjnë në fuqi me anë të procedurave përkatëse të parashikuara.

Neni 15
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

Marrëveshja në fjalë do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga të dyja njoftimet, me të cilat Palët Kontraktuese do të komunikojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave të brendshme respektive të parashikuara për këtë qëllim.

Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje prej tre vjetësh dhe do të rinovohet automatikisht për periudhat në vijim me kohëzgjatje të njëjtë.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë dhe denoncimi do të hyjë në fuqi vetëm gjashtë muaj pasi të njoftohet Pala tjetër Kontraktuese.

Në dëshmi të sa më sipër, përfaqësuesit nënshkrues, të autorizuar posaçërisht nga qeveritë e tyre respektive, nënshkruan këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më…… në dy origjinale, secili në gjuhët shqipe dhe italiane. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën italiane do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS ITALIANE
Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Lulzim Basha	Ambasadori Italian në Tiranë Attilio Massimo Iannucci

SHTOJCA 1
PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT
PUNIMET E PËRSHTATJES SË RRUGËS SHKODËR-HANI I HOTIT
SHTOJCË TEKNIKE

A) NDËRHYRJET DHE PUNËT E PARASHIKUARA

Ndërhyrja për rehabilitimin e rrugës fillon në Shkodër, në afërsi të krahut verior të urës së tanishme mbi lumin Drin, në këmbët e kështjellës së Rozafës - ku përfundon aksi rrugor i rehabilituar së fundi, që vjen nga Tirana e mbaron në kufirin me Malin e Zi në Han të Hotit.

Veprat e parashikuara synojnë përmirësimin jo vetëm të standardit të aksit ndërurban përtej Shkodrës, por edhe atij të brendshëm të këtij qyteti.

Me përjashtim të sa do të përcaktohet më mirë në projektin përfundimtar, projekt që do t'i besohet me tender një shoqërie inxhinierike, punimet do të fillojnë nga km. progresiv 00+00h, i lokalizuar në fundin e lumit Drin të lartpërmendur, dhe në thelb konsistojnë në:

- Realizimin e një unaze të brendshme në Shkodër, duke restauruar rrugët ekzistuese me përkatësitë e tyre (ndriçime, drenazhime, trotuare etj.) me anë të riparimit:
- në gjysmëunazën lindore, të veshjes më sipërfaqësore të rrugës për rreth 6km.
- në gjysmëunazën perëndimore, të të gjithë korpusit rrugor për rreth 3.5 km.

Traseja e brendshme e dy unazave është paraqitur e detajuar në procesverbalin e mbledhjes së datës 6 prill 2005, me kryetarin e zonës së Shkodrës dhe kryetarin e bashkisë së Shkodrës, që këtu kuptohet si e paraqitur tërësisht.

- Realizimin e një rruge të re lidhëse në veri, midis unazës së re dhe asaj drejt Hanit të Hotit, për të evituar interferencat me zonën e tregut dhe doganës.

Për vijën ndërurbane nga Shkodra deri në kufirin e Hanit të Hotit, parashikohet:

- Zgjerimi i seksionit rrugor ekzistues nga 6-7,20 metra në 10,50 metra (2 korsi 4.0 mt për kah me dy bankina anësore me nga 1,25 mt) për rreth 33 km;
- Variante jashtë vije për eliminimin e vështirësive plano-altimetrike, gjithmonë duke mbajtur po atë seksion me 10,5 metra gjerësi, pranë dy hendeqeve hekurudhore, të një ure me prerje gjatësore si "fije e lëshuar" dhe të rrugës fundore drejt kufirit me Malin e Zi.
- Vepra të urbanizimit parësor (drenazhime, trotuare të gjera, ndriçim etj.) në rrugët urbane që përshkojnë qendrat urbane të Koplikut, Bajzës dhe Banus, si dhe të qendrave të tjera të banuara.
- Ribërje e plotë e katër urave nga 30 m me një hapësirë drite dhe e një viadukti me katër hapësira drite nga 30 metra, për një gjatësi të përgjithshme prej 120m, me trarë çeliku Corten që vetëmbrohen nga oksidimi. Ndërkatësja është parashikuar me betonarme të hedhur në vepër mbi elemente parafabrikate.
- Punime në sistemin hidraulik për një shpërndarje të rregullt e të shpejtë të ujërave të reshjeve dhe riparimin e mbyllësve të shtoneve dhe kutive të betonit të nevojshme, si dhe të pritave e parapeteve të prekura nga punimet e reja;
- Impiante sigurie: (barriera), sinjalistikë (horizontale e vertikale) dhe ndriçim (kryqëzime e bashkime);
- Ndërhyrje për minimizimin, zbutjen dhe kompensimin e ndikimit mbi mjedisin, përsa i përket ajrit, mjedisit hidrik, tokës e nëntokës, florës e faunës, zhurmave e bukurive të peizazhit;
- Veprat e mbjelljes dhe pyllëzimit;
- Eliminimi i interferencave me linjat e ujësjellësit, ato telefonike dhe elektrike;
- Marrja e masave të duhura gjatë punimeve në prani të trafikut, për të mos penguar rrjedhjen e rregullt të mjeteve, përfshi këtu edhe punimet për rehabilitimin mjedisor pas përfundimit të fazës së kantierizimit.
- Aktivizimi i procedurave operative, pregatitje e pajisje për garantimin e sigurisë maksimale të punëtorëve në kantier.

Në bazë të verifikimeve të kryera bashkërisht midis ekspertëve italianë dhe Palës Shqiptare, shuma totale e punimeve është e barabartë me 20.765.000 euro, e ndarë sipas zërave të veçantë, që detajohen si më poshtë:

Përshkrimi i zërit të shpenzuar	Vlera në euro
By-pass i Shkodrës	
Degëzimi i afrimit	1.265.000
Gjysmëunaza lindore	1.500.000
Gjysmëunaza perëndimore	2.000.000
Rruga ndërurbane	
Rrugë në tokë	7.200.000
Vepra arti kryesore	4.400.000
Vepra arti të vogla	2.000.000

Mbrojtje	200.000
Trotuare dhe ndriçim	1.000.000
Mbrojtje e rrugës buzë liqenit	640.000
Sinjalistika	400.000
Eliminimi i interferencave	100.000
Nëntotali	20.765.000
Shërbime inxhinierike	935.000
Totali	21.700.000 euro

Theksohet se këto kosto duhen kuptuar si vlera maksimale.

Shpenzimet lokale nuk mund të tejkalojnë 45% të shumës së kredisë së ndihmës, me përjashtim të një autorizimi tjetër të KD-së. Pas rezultateve të tenderit, komiteti drejtues i MPJ/DPBZH-së ruan të drejtën e ngritjes së kësaj përqindjeje, gjithmonë kjo e justifikuar për arsye teknike ose shkaqe të rëndësishme tekniko-shoqërore.

Veprimtaritë e nevojshme

Veprimtaritë që duhen financuar në kuadrin e këtij propozimi mund të përmblidhen kështu:

- Shërbime inxhinierike: projektim paraprak, përfundimtar dhe SIA përveç drejtimit të punimeve (për t'iu besuar një shoqërie inxhinierike).

- Ndërhyrje dhe punë ndërtimi (për t'iu besuar një shoqërie ndërtimi).

Shërbimet inxhinierike të nevojshme për fuqizimin e rrugës do të besohen me anë të tenderit, që duhet të zhvillohet në përputhje me procedurat e Bashkimit Europian dhe me kriteret e zbatuara në ndërhyrje të tjera rrugore të bashkëpunimit italian në Shqipëri.

Projektimi duhet të kryhet duke mbajtur kontakte të vazhdueshme si me porositësin italian, ashtu dhe me entet përfituese shqiptare (MT&T dhe GRD). Drejtimi i punimeve, me anë të pranisë së vazhdueshme të personelit të ngarkuar, duhet të synojë paraprirjen e zgjidhjes së çdo problemi pengues për zhvillimin normal të punimeve, duke siguruar kështu realizimin në përputhshmëri të plotë të punëve të projektuara.

PËRMBLEDHJE E KOSTOS SË PËRGJITHSHME TË PROJEKTIT PA TVSH DHE SHPRONËSIMET

Zëri i kostos	Vlera totale (euro)	Në ngarkim të Italisë (euro)	Italia %
Detyrime për punimet e përmirësimit të rrugës urbane në Shkodër dhe ndërurbane deri në Han të Hotit	20.765.000	20.765.000	100
Detyrime për projektimin e by-passit të Shkodrës dhe rrugës ndërurbane deri në Han të Hotit	485.000	485.000	100
Detyrime për DL, koordinim sigurie, kontabiliteti për by-passin dhe gjithë rrugën Shkodër-Hani i Hotit	450.000	450.000	100
Totali i kredisë së ndihmës	21.700.000	21.700.000	100
Detyrimi për monitorimin nga ana e DGCS-së	150.000	150.000	100
Totali i donacionit	150.000	150.000	100
Totali rrumbullak-buxheti i kërkuar	21.850.000	21.850.000	100

Modalitetet e besimit të punimeve të firmës zbatuese, do të jenë pikërisht ato të sipërmarrjes së plotë, mbi bazën e të cilit kontratat e sipërmarrjes së punëve publike, përveç zbatimit të punimeve, mund të kenë për objekt edhe projektimin zbatues.

Tenderi për seleksionimin e firmës zbatuese do të bëhet në bazë të projektit përfundimtar (që do t'i besohet shoqërisë inxhinierike), të pajisur me skemën e kontratës dhe kushtet e veçanta të sipërmarrjes. Te kushtet duhet të parashikohet vendi dhe koha e projektit zbatues, si dhe modalitetet e kontrollit të respektimit nga ana e firmës të pikave të projektit përfundimtar.

Përsa i përket projektit përfundimtar, "grafikët e përpunuar dhe deskriptivë, si dhe llogaritjet paraprake do të përcaktohen në një nivel të tillë, që në projektimin pasues të mos ketë diferenca të mëdha teknike dhe të kostos".

Mënyra e sipërmarrjes së plotë bëhet e nevojshme, pasi ekzistojnë karakteristikat e veçanta të vështirësisë në punën e projektuar, si realizimi i urave.

Shoqërisë inxhinierike, përveç drejtimit të punimeve, do t'i kërkohet për këtë arsye projekti maksiml e përfundimtar dhe studimi i ndikimit në mjedis, në përputhje me rregullat e procedurat në fuqi. Ndërmarrjes do t'i besohet kështu realizimi e projektimi i zbatimit. Ky i fundit duhet të ketë edhe një përcaktim të ndërhyrjeve të lehtësimit mjedisor dhe planin e sigurimin e kantierit, duke parashikuar kështu kostot që rrjedhin nga mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurimit të punëtorëve në kantier.

Shpenzimet lokale, siç është dhënë më lart, nuk mund të tejkalojnë 45% të shumës së kredisë së ndihmës.

Fazat kryesore në përdorimin e kredisë së ndihmës, në bazë të procedurave në fuqi, mund të përmblidhen kështu:

11. Mendimi favorizues nga ana e komitetit drejtues të DPBZH-së për propozimin e financimit në fjalë.

12. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Projektit, që përmbledh brendinë e propozimit të financimit, cakton detyrimet e Palëve në realizimin e ndërhyrjes dhe ndjekjen e veprimeve përkatëse.

13. Nxjerrja nga ana e Ministrisë Italiane të Ekonomisë, me propozim të MPJ-së, të një dekreti ministerial, që autorizon Artigancassa-n të negociojë për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare me Ministrinë Shqiptare të Financave (MF).

14. Lidhja e Marrëveshjes financiare midis Artigancasa-s dhe MF-së.

15. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit për porositjen e shërbimeve inxhinierike (projektim e drejtim punimesh), nga ana e NJZP-së kompetente pranë ministrisë shqiptare të linjës dhe me mbështetjen e DPBZH-së.

16. Verifikimi, nga ana e MPJ-DPBZH-së, i rregullsisë së dokumentacionit të mësipërm dhe në rast rezultati pozitiv, shpallja e tenderit me një publikim të njëkohshëm të njoftimit në Itali (në ngarkim të MPJ-DPBZH-së) dhe në Shqipëri.

17. Vlerësimi i ofertave të ardhura, nga komisioni i ngritur nga ministria shqiptare kompetente dhe dhënia e porosive, me klauzolë pezullimi.

18. Verifikimi nga ana e MPJ-DPBZH-së i rregullsisë së procedurës së ndjekur të seleksionimit dhe të kontrarës që do të lidhet, dhe në rast rezultati pozitiv, lidhja e kontrarës nga ana e ministrisë kompetente shqiptare.

19. Në përfundim të veprimtarisë projektuese, verifikimi nga ana e MPJ-DPBZH, i dokumentacionit të tenderit për punimet dhe në rast rezultati pozitiv, shpallja e tenderit nga ana e ministrisë kompetente shqiptare me një publikim të njëkohshëm të njoftimit në Itali (në ngarkim të MPJ-DPBZH-së dhe në Shqipëri).

20. Vlerësimi i ofertave, nga komisioni i ngritur nga ministria shqiptare kompetente dhe dhënia e sipërmarrjes së punimeve, me klauzolë pezullimi.

21. Verifikimi nga ana e MPJ-DPBZH-së i rregullsisë së procedurës së ndjekur të seleksionimit dhe të kontratës që do të lidhet, dhe në rast rezultati pozitiv, lindja e kontratës për punimet nga ana e ministrisë kompetente shqiptare.

22. Mbështetja e kontratave të veçanta, të lidhura dorë pas dore, në Marrëveshjen financiare.

4.3 KRONOGRAMA

Në tërësinë e tij, realizimi i projektit parashikohet në harkun kohor të 3 vjetëve.

SHTOJCA 2
TENDERAT E SHËRBIMEVE, FURNIZIMEVE DHE PUNIMEVE
(KUSHTET E VEÇANTA)

Kjo shtojcë i referohet përdorimit të kredisë së ndihmës italiane.

Dhënia e kontratave do të kryhet nëpërmjet tenderave të hapur, të rezervuar vetëm për shoqëri

italiane. Përqindja e kredisë së ndihmës e përdorshme për kosto lokale dhe/ose për vende drejt zhvillimit, nuk mund të kalojë 45% të vetë kredisë.

Për dhënien e të gjithë tenderave të parashikuar në Program, do të adoptohen procedurat e parashikuara në manualin e procedurave (i përshtatur nga Komosioni Europian më 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të tjera të mundshme që kanë të bëjnë me: tenderat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Në çdo rast procedura e seleksionomit duhet të përfshijë:

1. Verifikimi i përputhshmërisë së ofruesve (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje), që do të konsiderohen jo të aftë atëherë kur:

a) janë në gjendje falimentimi, likuidimi, administrim i kontrolluar ose me preventiv të koordinuar, ndërprerje veprimtarie ose që janë objekt i një procedimi të ngjashëm i parashikuar nga ligjet dhe rregullat kombëtare;

b) janë objekt i një procedure për deklarim falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar, preventiv i konkorduar ose të një procedimi të ngjashëm të parashikuar nga ligjet dhe nga rregullat kombëtare;

c) janë dënuar me vendim të formës së prerë pa të drejtë apelimi për shkelje të etikës profesionale;

d) janë deklaruar përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave profesionale të provuara me elemente të çfarëdolloj dokumentacioni të administrarës gjyqësore;

e) nuk kanë bërë derdhje të rregullta të detyrimit të sigurimeve shoqërore sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë permanentë;

f) nuk kanë bërë derdhje të rregullta të detyrimeve ligjore mbi taksat sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë permanentë;

g) janë shpallur fajtorë për pasaktësi lidhur me dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata juridike lidhur me sa më sipër;

h) janë shpallur fajtorë, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale, të mospërmbushjeve të rënda në lëndën e zbatimit, në kuadër të një kontrate tjetër të nënshkruar me të njëjtën administratë juridike ose në kuadër të një kontrate tjetër të financuar nëpërmjet fondeve komunitare.

Përveç kësaj, ofruesve italianë do t'u duhet të paraqesin një certifikatë ose një deklaratë të ngjashme që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e dhëna në dekretin legjislativ italian, 8 gusht 1994, nr.490 ("Antimafia").

Ofruesit duhet të paraqesin, në mbështetje të ofertave të tyre, provat e duhura konform legjislacionit të vendit ku janë permanent, që vërteton se ata nuk janë ndodhur në asnjë nga situatat e parashikuara në pikat (a), (b), (c), (e) dhe (f).

2. Verifikim i gjendjes ekonomike dhe financiare të ofruesve përmes:

a) një deklarate të kapitalit social të shoqërisë dhe faturimeve në tre vitet e fundit gjatë tenderimeve;

b) një deklarate të xhiros totale të konkurruesve, në rast të një "*Joint Venture*" të përkohshme, të xhiros së secilit prej pjesëmarrësve;

c) një deklarate që tregon xhiron e sektorëve specifikë, të cilëve u referohet tenderi ose sektorin për të cilin, në rast të një bashkimi të përkohshëm shoqërish, shoqëria individuale synon të kontribuojë;

d) një deklarate të përshtatshme të përfaqësuesve ligjorë ose një certifikate bankare, që përmban informacion mbi marrëdhëniet me institucionet bankare me rëndësi ndërkombëtare për të demonstruar pranueshmërinë komerciale dhe financiare të konkurruesve dhe shoqërive që përbëjnë bashkimin e përkohshëm të shoqërive;

e) një certifikate që vërteton se konkurruesi është anëtar i dhomës së tregtisë në vendin ku është permanent;

f) në rast të një bashkimi të përkohshëm shoqërish, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së asocimit, që tregon shoqërinë që merr përsipër rolin e palës përgjegjëse përkundrejt MIE-s lidhur me zbatimin e kontrarës.

3. Verifikimi i kapacitetit teknik dhe profesional të konkurruesve përmes:

a) kopjes së dokumenteve origjinale që vërtetojnë përbërjen ligjore dhe/ose statusin juridik dhe që përcaktojnë vendin e regjistrimit dhe/ose selinë qendrore ose zyrën e regjistrimit dhe nëse këto

të dhëna nuk përputhen, vendndodhjen e selisë qendrore të kompanisë, shoqërisë ose partneritetit, ose të pjesëve të ndryshme që përbëjnë konkurruesit, në rast të një bashkimi të përkohshëm shoqërish;

b) një raporti që përmban dokumentacion informativ mbi precedentët e eksperiencës së punës së konkurruesve ose të bashkimit të përkohshëm në tendera me natyrë të ngjashme në tre vitet e fundit, dhe lidhur me tenderat e tjerë që janë duke u kryer, kërkohet gjithashtu informacion specifik rreth efektivitetit dhe pjesëmarrjes konkrete në çdo tender;

c) kualifikimeve dhe eksperiencave të stafit kyç që do të ngarkohen nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës;

d) një raporti të shkurtër mbi veprimtarinë e konkurrentëve, të vetëm apo të asociuar, me referim specifik mbi veprimtaritë e lidhura me programin.

Krahasimi midis konkurrentëve, mbi bazën e kritereve të vlerësimit të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, do të kryhet duke përdorur kriteret e përcaktuara dhe duke vlerësuar çmimin për identifikim të konkurrentëve ekonomikisht më të favorizuar.

Kriteret duhet të jenë precize, jo diskriminuese dhe as paragjykuese për një konkurrim korrekt.

SHTOJCA 3
MËNYRAT E ZBATIMIT DHE TË ADMINISTRIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS

SEKSIONI I
NXJERRJA E NJOFTIMEVE TË TENDERIT, PROCEDURA APLIKUESE

Dokumentacioni duhet të përgatitet konform shtojcës 2, që përmend manualin e procedurave (i përshtatur nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002), dhe ndryshimeve të mundshme të bëra më pas, që lidhen me: kontratat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta. Dokumentacioni, në çdo rast:

- duhet të saktësojë "kushtet specifike" për çdo tender;
- duhet të shprehë kriteret e vlerësimit që do të përdorë komisioni i krijuar në MPPTT.

1. Përgatitja e dokumenteve të tenderit

MPPTT-ja do të përgatisë dokumentacionin e tenderit për seleksionimin e kontraktuesit (punime, supervizion punimesh) dhe do t'ia dërgojë Ambasadës/NJTQ me kërkesën për të publikuar njoftimin për tenderat, në gazetat italiane.

2.Verifikimi i përputhshmërisë së dokumentacionit të tenderit

Verifikimi i përputhshmërisë me Marrëveshjen aktuale do të kryhet nga MPJ/DPBZH-ja, në bazë të përputhjes së:

- përmbajtjeve me karakter ligjor me procedurat e dhëna në shtojcën 2;
- specifikimeve teknike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që Programi propozon të arrijë.

3. Publikim i njoftimit

Në rast të një verifikimi pozitiv, njoftimi i tenderit do të publikohet nga ana e MPJ/DPBZH-së në gazetat italiane, në buletinin e bashkëpunimit dhe në faqen e internetit të MPJ-së. MPPTT-ja do të procedojë në të njëjtën mënyrë me publikimin e njoftimeve të tenderave në gazetat kombëtare.

SEKSIONI II
FAZA E VLERËSIMIT
- PROCEDURA E ZBATUAR

1. Kontrolli i ofertave të dorëzuara për çdo tender do të kryhet nga një komision vlerësimi i krijuar enkas nga MPPTT-ja. Ambasada/NJTQ do të caktojë një përfaqësues të vetin, që do të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit gjatë procesit të hapjes së ofertave.

2. Për çdo garë NJZP-ja do t'i transmetojë Ambasadës/NJTQ dokumentacionin, që përmban aktet e komisionit, së bashku me kontratën për firmë, duke kërkuar miratimin për firmosjen e kontratës. Ky dokumentacion do të dërgohet nga Ambasada Italiane/NJQT te MPJ/DPBZH-ja, së bashku me komentet e mundshme.

3. MPJ/DPBZH-ja do të verifikojë parimisht përputhjen ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera, me procedurat dhe kriteret/parametrat e parashikuar në dokumentet e tenderit. Mbasi të jetë

kryer verifikimi, MPJ/DPBZH do të informojë Ambasadën për rezultatet.

4. Në rast të një konkludimi pozitiv (*nulla osta*), MPPTT-ja do të procedojë për firmosjen e kontratës me shoqëritë që do të rezultojnë fituese.

SEKSIONI III
FAZA E DHËNIES SË KONTRATAVE DHE LIVRIMEVE TË FONDIT
- PROCEDURA E ZBATUAR

1. Kontratat e zyrtarizuara ndërmjet shoqërive fituese dhe MPPTT-së duhet të dërgohen në MPJ/DPBZH nëpërmjet Ambasadës/NJQT, me deklaratën e impenjimit të Palës Shqiptare për të përballuar kostot lokale në lidhje me TVSH-në, taksat doganore, shpronësimet etj.

2. Mbas verifikimit të përputhshmërisë së kontratës me dokumentacionin e tenderit, MPJ/DPBZH-ja do të autorizojë Artigancassa-n që të mundësojë pagesat e kontratave në bazë të Marrëveshjes financiare.

3. Sapo të marrë autorizimin e parashikuar në pikën 2, Artigiancassa do të përfundojë hetimet, veçanërisht në lidhje me eksportuesin italian. Pas përfundimit pozitiv të hetimeve dhe ardhjes së kërkesës për financim nga ana e kredimarrësit, Artigiancassa do t'i komunikojë kredimarrësit, eksportuesit dhe MPJ/DPBZH-së futjen dhe financimin e kontratave në bazë të Marrëveshjes financiare.

4. Artigiancassa do të fillojë disbursimin në favor të furnizuesve pasi këta të fundit të paraqesin kërkesën për disbursim së bashku me dokumentacionin administrativ të bashkëngjitur, siç është parashikuar në çdo kontratë (faturat tregtare, *packing list, bill of lading* etj.) dhe pasi të ketë verifikuar përputhshmërinë e të njëjtit dokumentacion me kontratën e autorizuar. (Kërkesa për disbursim do t'i dërgohet në kopje kredimarrësit). Pagesat do të mund të kryhen vetëm pasi të autorizohen nga ana e kredimarrësit; ky autorizim duhet të vijë brenda 30 ditëve duke filluar nga data e secilës kërkesë për disbursim.

LIGJ
Nr.9630, datë 30.10.2006

PËR FAKTORINGUN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet e palëve në një kontratë faktoring si dhe kalimin e kredive të llogarisë klient.

2. Për ato çështje që nuk rregullohen nga ky ligj, palët e kontratës faktoring dhe marrëdhëniet

juridike, që lindin ndërmjet tyre, do t'u nënshtrohen dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi.

Neni 2
Kontrata faktoring

1. Kontrata faktoring, për qëllimin e këtij ligji, quhet kontrata e lidhur me shkrim ndërmjet furnizuesit dhe faktorit, nëpërmjet së cilës:

a) furnizuesi mund t'i shesë apo i shet faktorit kredi të llogarisë klient, që ekzistojnë në çastin e lidhjes së kontratës faktoring dhe/ose që mund të krijohen më pas, të cilat kanë lindur dhe/ose do të lindin nga kontrata për shitjen e sendeve dhe/ose shërbimeve, të lidhura ndërmjet furnizuesit dhe klientëve të tij, debitorëve, duke përjashtuar ato për shitjen e sendeve dhe/ose shërbimeve, që blihen për përdorim personal, familjar ose shtëpiak;

b) faktori kryen të paktën dy nga veprimet e mëposhtme:

i) financon furnizuesin, duke përfshirë parapagimet;

ii) mban llogaritë, që lidhen me kreditë e llogarisë klient;

iii) mbledh kreditë e llogarisë klient;

iv) mbron furnizuesin nga paaftësia paguese e debitorëve, si pasojë e pamundësisë së tyre financiare për të paguar;

c) debitori duhet të njoftohet për kalimin e kredive të llogarisë klient.

2. Kontrata faktoring lidhet si për kredi vendase, ashtu edhe për kredi ndërkombëtare.

3. Kontrata faktoring nuk është kontratë huaje apo kontratë për transferimin e kredive të llogarisë klient, që lidhet vetëm për të lehtësuar mbledhjen e llogarive.

4. Në kuptim të këtij ligji, kontrata, ku faktori dhe furnizuesi janë i njëjti subjekt, nuk është kontratë faktoring.

Neni 3
Objekti i kontratës faktoring, kreditë ekzistuese dhe/ose të ardhshme

1. Objekt i kontratës faktoring janë kreditë ekzistuese dhe/ose të ardhshme të llogarisë klient, të cilat kanë lindur dhe/ose do të lindin nga shitja e sendeve dhe/ose shërbimeve nga furnizuesi te klienti (debitori). Kreditë e llogarisë klient, objekt i kontratës faktoring, mund të jenë vendase ose ndërkombëtare.

2. Kreditë e llogarisë klient mund të kalohen edhe përpara lidhjes së kontratave nga të cilat ato do të rrjedhin. Kreditë e llogarisë klient, qofshin ekzistuese apo të ardhshme, mund të kalohen në tërësi.

3. Kalimi në tërësi i kredive të ardhshme të llogarisë klient mund të bëhet vetëm për kreditë që rrjedhin nga kontrata, të cilat lidhen brenda një afati maksimal njëzet e katër muaj nga data lidhjes së kontratës faktoring.

4. Dispozitat e kontratës faktoring janë të vlefshme edhe kur nuk identifikojnë individualisht kreditë, ekzistuese ose të ardhshme, të llogarisë klient, objekt i kontratës faktoring, nëse këto kredi identifikohen në kontratën faktoring në kohën e lidhjes së saj ose në kohën e lindjes së këtyre kredive.

5. Dispozitat e kontratës faktoring, që parashikojnë kalimin e kredive të ardhshme të llogarisë klient te faktori, zbatohen menjëherë, në çastin kur lindin kreditë në fjalë, pa qenë i nevojshëm nënshkrimi i një kontrate të re, për realizimin e kalimit të kredive të llogarisë klient.

6. Lidhja nga furnizuesi me më shumë se një faktor e kontratave të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji, të cilat kanë objekt të njëjtat kredi të llogarisë klient, për të njëjtin debitor, është e ndaluar. Këto kontrata kur lidhen janë të pavlefshme. Shkelja e kësaj dispozite, kur përbën vepër penale, dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

Lidhja e kontratave faktoring nuk është e kundërligjshme, nëse faktorët e lartpërmendur kanë rënë dakord për lidhjen e këtyre kontratave.

Neni 4
Kontrata e lidhur midis faktorit dhe furnizuesit

Shitja e kredive të llogarisë klient nga furnizuesi te faktori ka përparësi dhe është e vlefshme pavarësisht nga ndonjë kontratë apo marrëveshje e lidhur ndërmjet furnizuesit dhe debitorit, e cila ndalon kalimin e kredive.

Neni 5
Llojet e kontratës faktoring

Kontrata faktoring përfshin këto lloje:

a) faktoring vendas, eksporti ose importi;

b) faktoring pa garanci, ku furnizuesi nuk garanton faktorin për aftësinë paguese të debitorit. Megjithatë, furnizuesi mbetet përgjegjës dhe i detyruar kundrejt faktorit, nëse për çfarëdolloj arsyeje, të ndryshme nga paaftësia paguese, debitori nuk paguan tërësisht kredinë e llogarisë klient;

c) faktoring me garanci, ku furnizuesi garanton plotësisht faktorin për pagimin e kredisë së llogarisë klient nga debitori.

Neni 6
Njoftimi i debitorit

1. Faktori ose furnizuesi njofton debitorin me shkrim, përfshirë faksin, mesazhet e dërguara me postë elektronike dhe çdo lloj telekomunikimi, që mund të riprodhohet në mënyrë të prekshme. Njoftimi vlerësohet i realizuar kur i ka mbërritur marrësit.

2. Përmbajtja e njoftimit përfshin deklarimin e ekzistencës së kontratës faktoring, të lidhur ndërmjet faktorit dhe furnizuesit, si dhe identifikimin e faktorit dhe të kredive të llogarisë klient, që janë objekt i kontratës faktoring.

3. Njoftimi kryhet brenda një afati të përcaktuar në kontratën faktoring.

Neni 7
Mbarimi i kontratës faktoring

Kontrata faktoring mbaron me përfundimin e afatit kohor, për të cilin ajo është lidhur. Nëse kohëzgjatja nuk është përcaktuar, kontrata faktoring përfundon pasi të jenë shlyer plotësisht të gjitha kreditë e llogarisë klient, të transferuara nëpërmjet kësaj kontrate.

KREU II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE NË TRANSAKSIONET FAKTORING

Neni 8
Palët në transaksion

Palët pjesëmarrëse në transaksionet faktoring janë faktori, furnizuesi dhe debitori.

Neni 9
Faktori

Faktori është person juridik, i cili ofron shërbimet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji kundrejt shpërblimit, që mund të jetë një shumë e përcaktuar dhe/ose normë interesi, për një periudhë kohore të caktuar me marrëveshjen e palëve.

Neni 10
Subjektet që mund të kryejnë veprimtari faktoring

1. Mund të kryejnë veprimtari faktoring vetëm subjektet e mëposhtme:

a) bankat dhe institucionet financiare jobankare, të themeluara sipas legjislacionit në fuqi, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë;

b) shoqëritë tregtare, që kanë objekt vetëm veprimtarinë faktoring.

2. Nëse faktori krijohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, ai duhet të jetë një shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me kapital themeltar jo më të vogël se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, i cili të jetë i shlyer me kontribute në para, të paktën deri në shumën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

Neni 11
Furnizuesi

Furnizues është çdo subjekt, që ushtron veprimtari tregtare, i krijuar në përputhje me legjislacionin e vendit të origjinës, i cili i ofron debitorit sende dhe/ose shërbime dhe përfiton nga faktori shërbimet e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, kundrejt shpërblimit, që është një shumë e përcaktuar dhe/ose normë interesi, për një periudhë kohore të caktuar me marrëveshjen e palëve.

Neni 12
Debitori

Debitor është subjekti që blen sende dhe/ose shërbime nga furnizuesi dhe që ushtron veprimtari tregtare dhe është krijuar në përputhje me legjislacionin e vendit të origjinës.

Neni 13
Detyrimet e faktorit

1. Faktori pranon kalimin e kredive të llogarisë klient të furnizuesit, në përputhje me kontratën faktoring, siç parashikohet në nenin 2 të këtij ligji.
2. Faktori kryen shërbimet sipas kontratës faktoring, siç parashikohet në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 14
Detyrimet e furnizuesit

1. Furnizuesi përgjigjet kundrejt faktorit për ekzistencën dhe vlefshmërinë e kredive të llogarisë klient, të cilat janë objekt i kontratave të përmendura në nenin 3 të këtij ligji dhe që i kalojnë faktorit të lira nga çdo barrë, mosmarrëveshje, prapësim, pretendim apo nga çdo e drejtë tjetër e të tretëve.
2. Furnizuesi është i detyruar që, jo më vonë nga çasti kur faktorit i lindin të drejtat, që burojnë nga kontrata faktoring, të vërë në dispozicion të faktorit, sipas nenit 507 të Kodit Civil, çdo të dhënë ose dokument, që provon ekzistencën e kredive të llogarisë klient, objekt i kontratës faktoring.
3. Nëse debitori, edhe pse është njoftuar sipas nenit 6 të këtij ligji, ekzekuton, gabimisht ose për çdo lloj arsyeje tjetër, në favor të furnizuesit kreditë e llogarisë klient, që furnizuesi ia ka kaluar faktorit nëpërmjet kontratës faktoring, furnizuesi detyrohet t’i transferojë menjëherë faktorit fondet, që ka përfituar nga ekzekutimi i kredisë prej debitorit.

Neni 15
Mjetet e sigurimit për kontratën faktoring

Faktori dhe furnizuesi mund të parashikojnë në kontratën faktoring mjete për sigurimin e transaksioneve faktoring. Mjetet e sigurimit përfshijnë depozitën, barrën siguruese, pengun, dorëzaninë ose mjete të tjera sigurimi, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 16
Të drejtat e debitorit

1. Debitori ka të drejtë të njoftohet për kontratën faktoring, kreditë e llogarisë klient, objekt i

kontratës, dhe identitetin e faktorit.

2. Të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara për debitorin në kontratën e lidhur ndërmjet tij dhe furnizuesit mbeten të pandryshuara, pavarësisht nga ndryshimi i palës, në favor të së cilës debitori ekzekuton kredinë.

Neni 17
Detyrimi për të paguar

1. Debitori është i detyruar të paguajë faktorin vetëm nëse nuk është në dijeni për përparësinë e një subjekti tjetër për t'u paguar dhe nëse njoftimi me shkrim për kalimin e kredisë:

a) i është dhënë debitorit nga furnizuesi ose nga faktori, me miratimin e furnizuesit;

b) identifikon, për aq sa është e mundur, kreditë e llogarisë klient, të kaluara në favor të faktorit, kundrejt të cilit debitori duhet të paguajë kredinë;

c) u referohet kredive të llogarisë klient, që kanë lindur nga një kontratë shitjeje sendesh dhe/ose shërbimesh, e lidhur përpara ose në kohën e dhënies së njoftimit.

2. Pasi të jetë kryer njoftimi në mënyrën e duhur, debitori paguan faktorin, sipas kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet furnizuesit dhe debitorit.

Neni 18
Shkarkimi nga detyrimi

Debitori shkarkohet nga detyrimi kur kryen pagesën e kredisë në favor të faktorit, në përputhje me parashkimet e nenit 17 të këtij ligji, si dhe në çdo rast tjetër, kur kryerja e pagesës së kredisë nga debitori, në favor të faktorit, e çliron debitorin nga detyrimi.

Neni 19
Prapësimet dhe mbrojtja e debitorit

1. Nëse faktori ka pretendime ndaj debitorit për pagesën e një kredie të llogarisë klient, që lind nga një kontratë shitjeje sendesh dhe/ose shërbimesh, debitori ka të drejtë t'i kundrejtojë faktorit të gjitha prapësimet, të cilat do t'ia kundrejtonte furnizuesit.

2. Gjithashtu, debitori ka të drejtë të kërkojë nga faktori kompensimin e kredisë së llogarisë klient, që i ka kaluar faktorit me kredi të debitorit ndaj furnizuesit, të cilat lindin në çastin kur debitori ka marrë njoftimin me shkrim për kalimin e kredive, sipas neneve 6 dhe 17 të këtij ligji.

Neni 20
Kthimi i shumave që debitori i ka paguar faktorit

1. Mospërmbushja ose përmbushja e parregullt apo me vonesë e kontratës së shitjes së sendeve dhe/ose shërbimeve, pa cenuar të drejtat e debitorit, sipas nenit 19 të këtij ligji, nuk i jep atij menjëherë të drejtën për t'i kërkuar faktorit kthimin e shumës së paguar, edhe nëse debitori ka të drejtë të kërkojë kthimin e kësaj shume nga furnizuesi.

2. Debitori, i cili gëzon të drejtën që t'i kërkojë furnizuesit kthimin e shumës, që i ka paguar faktorit për një kredi të llogarisë klient, ka të drejtë t'i kërkojë faktorit kthimin e shumës në fjalë, kur faktori:

a) nuk ka bërë pagesën në favor të furnizuesit për kredinë në fjalë; ose

b) ka bërë pagesën në favor të furnizuesit për kredinë në fjalë, duke qenë në dijeni për mospërmbushjen ose përmbushjen e parregullt apo me vonesë të kontratës së shitjes së sendeve dhe/ose shërbimeve nga furnizuesi.

KREU III
KALIMET E NJËPASNJËSHME TË KREDIVE

Neni 21
Faktori ose subjekti, në favor të të cilit bëhet kalimi

1. Kur furnizuesi i kalon faktorit kredinë e llogarisë klient, nëpërmjet kontratës faktoring, në përputhje me këtë ligj:

a) dispozitat e neneve 3 dhe 20 të këtij ligji, sipas përcaktimeve në shkronjën "b" të këtij neni, zbatohen për çdo kalim të mëtejshëm të kredisë në fjalë tek të tretët;

b) dispozitat e neneve 17 dhe 20 të këtij ligji zbatohen ndaj subjekteve, të cilëve u kalon, në mënyrë të njëpasnjëshme, kredia në fjalë, njësoj si ndaj faktorit.

2. Njoftimi i debitorit për kalimin e njëpasnjëshëm kryhet nga faktori ekzistues ose faktori i ri.

Neni 22
Ndalimi i kalimit

Kontrata faktoring mund të kufizojë ose të ndalojë shitjet apo kalimet e njëpasnjëshme të kredisë së llogarisë klient.

KREU IV
REGJISTRIMI I KALIMIT TË KREDIVE

Neni 23
Regjistrimi i kalimit

Kalimi i kredive të llogarisë klient, nëpërmjet kontratës faktoring, çdo ndryshim apo shtesë, si dhe mbarimi i kontratës faktoring regjistrohen në regjistrin e barrëve siguruese.

Neni 24
Përmbajtja e regjistrit

Kërkesa për regjistrimin e kalimit të kredisë së llogarisë klient nëpërmjet kontratës faktoring përmban:

a) të dhënat për identifikimin e faktorit, furnizuesit dhe debitorit;

b) identifikimin e çdo kolaterali, që rregullohet nga kontrata faktoring;

c) nënshkrimin e personit, që kërkon regjistrimin në regjistër të kontratës faktoring, për kalimin e kredive të llogarisë klient.

Neni 25
Çasti dhe përparësia e regjistrimit

Të dhënat e përcaktuara në nenin 24 regjistrohen në regjistër në çastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe kanë përparësi ndaj pretendimeve të të tretëve.

Neni 26
Të dhëna të tjera të regjistrueshme

Faktori, furnizuesi ose debitori mund të kërkojnë të shënohet në regjistër ngritja e ndonjë padie, që lidhet me kontratën e faktoring. Shënimi përmban të dhëna për identifikimin e kërkesëpadisë dhe një përshkrim të shkurtër të saj. Gjithashtu, mund të regjistrohet edhe heqja dorë nga kërkesëpadia apo vendimet e tjera të lidhura me të.

Neni 27
Efektet e regjistrimit ndaj palëve të treta

1. Prezumohet se të tretët kanë dijeni për ekzistencën e kalimeve të regjistruara në regjistër.

2. Të dhënat e regjistruara në regjistër nuk përdoren për të vërtetuar pronësinë, përveç rasteve kur është deklaruar ndryshe, apo për të vërtetuar ndonjë të drejtë tjetër, që lidhet me kalimin e kredive të llogarisë klient, nëpërmjet kontratës faktoring ose si provë për vlefshmërinë e një transanksioni ligjor.

KREU V
DISPOZITA TË TJERA TË ZBATUESHME PËR FAKTORINGUN

Neni 28
Bankat

Kur veprimtaria faktoring, sipas përcaktimit të nenit 2 të këtij ligji, kryhet nga bankat, ajo do të mbikëqyret dhe rregullohet nga Banka e Shqipërisë.

Neni 29
Institucionet financiare jobankare

Kur veprimtaria faktoring, sipas përcaktimit të nenit 2 të këtij ligji, kryhet nga institucionet financiare jobankare, ajo i nënshtrohet legjislacionit përkatës të Republikës së Shqipërisë.

Neni 30
Trajtimi fiskal i faktoringut

Për tatimin mbi vlerën e shtuar, shërbimi faktoring trajtohet si shërbim financiar.

Neni 31
Falimentimi, riorganizimi dhe likuidimi

1. Faktori në proces falimentimi, riorganizimi ose likuidimi trajtohet nga gjykata, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

2. Kur ndaj debitorit fillon një procedurë falimentimi, riorganizimi ose likuidimi, detyrimi i tij për t'i paguar faktorit kredinë e llogarisë klient:

a) konsiderohet nga gjykata si një detyrim i pasiguruar;

b) konsiderohet nga gjykata si detyrim i siguruar, vetëm nëse është i siguruar me njërin nga mjetet e sigurimit;

c) vazhdon t'u nënshtrohet të njëjtave të drejta dhe detyrime, të parashikuara në nenet 16 e 17 të këtij ligji.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5116, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9631, datë 30.10.2006

PËR ARTIN SKENIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme, rregullat e organizimit, të funksionimit, realizimit dhe financimit të artit skenik, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve, që kanë për objekt veprimtarie artin skenik.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është nxitja, mbështetja dhe zhvillimi i krijimtarisë e i veprimtarisë së subjekteve të artit skenik për krijimin, ekzekutimin dhe kultivimin e veprave e të gjinive skenike.

Neni 3
Subjektet dhe fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe të shfaqjes së veprës artistike skenike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Art skenik” është përfshirja e gjinive, të cilat gërshetojnë në strukturën e tyre arte të ndryshme dhe që janë të destinuara, detyrimisht, të shfaqen për publikun në skena të hapura ose të mbyllura.

2. “Teatër” është hapësira ku zhvillohet dhe ajo çka ndodh në shfaqje, e gjallë dhe e drejtpërdrejtë, ndërmjet artistit dhe spektatorit.

3. “Vepër skenike” është krijimi i gjallë artistik i një teksti, platforme, partiture ose libreti, të përfunduar dhe të mundshëm për t'u shfaqur, për së gjalli dhe drejtpërdrejt, në publik.

4. “Veprimtari skenike” është krijimi, prodhimi, ekzekutimi, tregtimi dhe shfrytëzimi i veprës artistike skenike, zhvillimi i vlerave kombëtare, edukimi dhe shërbimet e lidhura me këtë veprimtari.

5. “Artist i skenës” është personi, që përcjell te publiku një vepër, e cila është e paracaktuar të komunikojë për së gjalli dhe drejtpërdrejt me të.

Janë të tillë edhe bashkëpunëtorët e veprës skenike, që shfaqen në publik.

6. “Fondi publik i artit skenik” është fondi i miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, si dhe të ardhurat e tjera të njohura me ligj, të paracaktuara për financimin e veprimtarisë së artit skenik.

7. “Projekt artistik" është çdo ide, e zhvilluar dhe e plotësuar deri në nivelin e shpjegimit të kuptueshëm, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e saj artistikisht. Projekti artistik mund të jetë i sferës së prodhimit, të edukimit, të promovimit, mund të jetë tradicional ose alternativ, privat ose shtetëror.

8. “Aplikim” janë kërkesat e subjektit për financimin nga fondi publik i artit skenik, në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

9. “Mbështetje financiare” është masa e financimit të një projekti artistik, dhënë një subjekti të caktuar nga fondi publik i artit skenik.

10. “Sezon artistik” është periudha e kufizuar e kohës, gjatë së cilës përcillet në publik veprimtaria skenike në vazhdim.

11. “Subjekte private të artit skenik” janë personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që

funksionojnë në mbështetje të ligjeve nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, që ushtrojnë veprimtari të artit skenik.

KREU II
INSTITUCIONET E ARTIT SKENIK

Neni 5
Ndarja e institucioneve të artit skenik

1. Institucionet e artit skenik janë subjekte publike dhe private.
2. Institucionet publike të artit skenik ndahen në qendrore dhe vendore.
3. Në institucionet publike qendrore të artit skenik përfshihen:
a) Teatri Kombëtar;
b) Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor;
c) Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë;
ç) Qendra Kombëtare e Artit Skenik.
4. Në insitucionet publike vendore të artit skenik përfshihen institucionet e artit skenik, në varësi të njësisë së qeverisjes vendore.

KREU III
INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE TË ARTIT SKENIK

Neni 6
Statusi dhe qëllimi i veprimtarisë

1. Institucionet publike qendrore të artit skenik janë persona juridikë, publikë, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Institucionet publike qendrore të artit skenik kanë si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së tyre nxitjen dhe zhvillimin e artit skenik, si krijimtari shpirtërore, ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, nëpërmjet studimit, edukimit, prodhimit, paraqitjes dhe shpërndarjes së veprave skenike; eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike; realizimin e veprave artistike të autorëve shqiptarë dhe të huaj, për të gjitha grupet e shtresat sociale; shkëmbimet teatrore ndërkombëtare, turnetë, festivalet, manifestimet intelektuale, riprodhimin audioviziv dhe botimet.

Neni 7
Drejtimi dhe funksionimi i institucioneve publike qendrore të artit skenik

1. Drejtimi dhe funksionimi i institucioneve publike qendrore të artit skenik realizohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të akteve nënligjore në zbatim të tij, statutit të institucionit, rregullores së bordit artistik dhe rregullores së brendshme të funksionimit.
2. Statuti propozohet nga titullari i institucionit dhe miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit të artit skenik miratohet nga titullari, ndërsa rregullorja e bordit artistik miratohet nga vetë bordi në mbledhjen e parë të tij.
4. Struktura dhe organika e institucioneve publike qendrore të artit skenik miratohen me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
5. Institucioni ka stemën, vulën dhe selinë, të cilat përcaktohen në statut.

Neni 8
Organet drejtuese

Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë administrative dhe artistike të institucioneve publike qendrore të artit skenik realizohen nga titullari i institucionit dhe bordi artistik.

Neni 9
Titullari

1. Institucioni publik qendror i artit skenik, sipas nenit 6, drejtohet nga titullari.

2. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i titullarit të institucionit publik qendror bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 10
Bordi artistik

1. Bordi artistik është organizëm kolegjial pranë institucionit publik qendror të artit skenik. Struktura e bordit dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve përcaktohen në statutin e institucionit. Titullari i institucionit thërret, organizon dhe drejton mbledhjet e bordit artistik.

2. Bordi artistik funksionon në përputhje me ligjin nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”.

3. Anëtarët e bordit artistik janë personalitete të shquara të fushës së artit dhe të veprimtarive shoqërore, që kanë lidhje me të. Anëtarët nuk mund të jenë të punësuar në institucionin pranë të cilit funksionon ky bord. Mandati i tyre është 3-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje vetëm një herë.

4. Anëtari i bordit artistik, përpara marrjes së çdo vendimi, është i detyruar të nënshkruajë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se nuk ka konflikt interesi, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe të dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

5. Bordi artistik, si rregull, mblidhet jo më pak se dy herë gjatë një sezoni artistik.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11
Kompetencat e bordit artistik

Bordi artistik i institucionit qendror të artit skenik ka këto detyra:

a) miraton, në mbledhjen e parë, rregulloren e funksionimit të tij, e cila propozohet nga titullari i institucionit;

b) vendos repertorin artistik vjetor të institucionit, në përputhje me politikën e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

c) miraton projektet artistike, në përputhje me repertorin e vendosur;

ç) miraton kriteret dhe kushtet e shpërblimit të vlerës artistike;

d) miraton paraqitjen ose pjesëmarrjen e institucionit në festivale e manifestime të tjera, duke përcaktuar edhe projektin pjesëmarrës.

Neni 12
Burimet e financimit

Burimet e financimit të institucioneve publike qendrore të artit skenik janë:

a) Buxheti i Shtetit:

i) financime nga Buxheti i Shtetit për shpenzimet operative e administrative, investimet dhe pajisjet teknike për administratën;

ii) financimi i përftuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për realizimin e repertorit vjetor skenik;

b) të ardhurat nga administrimi i kapitaleve fizike të tyre, si të arkivave, literaturës etj. dhe nga shitja e biletave;

c) të ardhurat e siguruara nga shitja e veprave skenike të prodhuara, tek të cilat ushtrohen të drejtat ekonomike dhe tregtare;

ç) të ardhurat e tjera, të siguruara nga aplikime në burime ligjore financimi për projekte të ndryshme dhe të veçanta, në përputhje me statutet e tyre;

d) sponsorizimet dhe donacionet;

dh) të ardhura të tjera të ligjshme.

Përdorimi i të ardhurave bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 13

Marrëdhëniet juridike të punës

Marrëdhëniet juridike të punës në institucionin publik qendror të artit skenik rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe me statutin e rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 14

Dispozitat e kreut III nuk gjejnë zbatim për Qendrën Kombëtare të Artit Skenik.

KREU IV

QENDRA KOMBËTARE E ARTIT SKENIK, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 15

Qendra Kombëtare e Artit Skenik

1. Qendra Kombëtare e Artit Skenik (QKAS) është person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që ka objekt të veprimtarisë menaxhimin e fondit publik për mbështetjen financiare të projekteve të paraqitura nga institucionet publike vendore të artit skenik ose nga persona fizikë apo juridikë, privatë, vendas ose të huaj, që kanë objekt verpimtarie artin skenik.

2. Struktura dhe organika përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Organizimi dhe funksionimi përcaktohen në statut, i cili miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bazë të propozimit të Kryetarit të Qendrës.

Neni 16

Kryetari

QKAS-ja drejtohet nga Kryetari, i cili emërohet, lirohet ose shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 17

Kompetencat e Kryetarit

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik ka këto kompetenca:

a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e bordit artistik të QKAS-së;

b) zbaton vendimet e bordit artistik dhe lidh kontratat me subjektet përfituese të fondeve financiare;

c) përcakton tarifat e aplikimit dhe të regjistrimit të subjekteve të artit skenik;

ç) përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;

d) ushtron kompetencat për drejtimin e veprimtarisë administrativo-ekonomike të QKAS-së dhe të gjitha kompetencat që nuk i janë dhënë shprehimisht bordit artistik.

Neni 18

Bordi artistik i QKAS-së

1. Bordi artistik është organizëm kolegjial pranë QKAS-së dhe funksionon në përputhje me ligjin nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”.

2. Bordi artistik përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit skenik nga pikëpamja e vlerave artistike dhe ekonomike.

3. Bordi artistik merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Vendimi i bordit artistik përfshin miratimin e projektit artistik dhe fondin financiar përkatës në të gjitha fushat e artit skenik dhe për të gjithë aplikantët, që kanë të drejtë të përfitojnë fonde, sipas këtij ligji.

5. Bordi artistik mblidhet jo më pak se dy herë në vit.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Përbërja e bordit artistik të QKAS-së

1. Bordi artistik përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen në bazë të propozimeve të mëposhtme:

a) një anëtar nga bordi artistik i Teatrit Kombëtar;

b) një anëtar nga bordi artistik i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë;

c) një anëtar nga bordi artistik i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor;

ç) një përfaqësues i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

d) një kritik i artit skenik, i propozuar nga Akademia e Shkencave;

dh) një përfaqësues nga Fakulteti i Artit Skenik;

e) një përfaqësues i Fakultetit të Muzikës në Akademinë e Arteve.

2. Anëtarët e bordit artistik kanë mandat 3-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje vetëm një herë.

3. Anëtarët e bordit artistik janë personalitete të fushës së artit dhe të veprimtarive të tjera shoqërore që kanë lidhje me të.

4. Përbërja nominative e bordit paraqitet nga Kryetari i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik dhe miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 20

Fondi publik i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik

Fondi i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik është publik, me zë më vete në Buxhetin e Shtetit. Ky fond administrohet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe për mbështetjen e projekteve artistike nuk i nënshtrohet legjislacionit për prokurimet publike.

Neni 21

Kompetencat e Qendrës Kombëtare të Artit Skenik

Qendra Kombëtare e Artit Skenik ka këto kompetenca:

a) zbaton politikat shtetërore në fushën e artit skenik, në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

b) shpall publikisht, në fillim të çdo viti, fondin publik të artit skenik jo më vonë se një muaj pas përcaktimit me hollësi të Buxhetit të Shtetit;

c) planifikon fondin publik të artit skenik, sipas gjinive të artit, mbështet dhe financon, plotësisht ose pjesërisht, projekte artistike të paraqitura nga subjektet publike të artit skenik vendor apo subjektet private të artit skenik;

ç) paraqet çdo vit kërkesat për mbështetje buxhetore të fondit publik të artit skenik, si dhe mbikëqyr përdorimin e financimeve nga subjektet e mbështetura prej saj;

d) mbledh, përpunon dhe u shpërndan subjekteve të artit skenik të dhëna të vlefshme në fushat e prodhimit, të edukimit dhe të promovimit të veprimtarisë skenike;

dh) nxit, bashkëpunon, financon ose bashkëfinancon projekte e programe në fushën e edukimit, të prodhimit dhe shpërndarjes së veprimtarive skenike kombëtare dhe ndërkombëtare;

e) regjistron subjektet e artit skenik, sipas kërkesave dhe kritereve profesionale të miratuara nga bordi artistik;

ë) siguron asistencë teknike, në shërbim të rritjes cilësore dhe të standardizimit të aplikimit të projekteve teatrore.

Neni 22
Burimet e financimit

Burimet e financimit të Qendrës Kombëtare të Artit Skenik janë:

1. Financime nga Buxheti i Shtetit, për financimin e projekteve të artit skenik, për investimet, pajisjet teknike për administratën, si dhe për shpenzimet operative administrative.

2. Të ardhurat nga tarifat për regjistrimin e subjekteve aplikuese për financim të projekteve të artit skenik.

3. Sponsorizimet dhe donacionet.

4. Të ardhura të tjera të ligjshme.

Neni 23
Kushtet dhe kriteret për gëzimin e së drejtës së aplikimit

1. Institucioni publik vendor i artit skenik, personi fizik apo juridik, privat, vendas ose i huaj, gëzon të drejtën e aplikimit për financim nga fondi publik i artit skenik vetëm pasi është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Artit Skenik.

Kushtet dhe kriteret e aplikimit përcaktohen dhe miratohen me udhëzim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Subjektet private të artit skenik, të cilat përfitojnë financime nga fondi publik i artit skenik, janë të detyruara të kontraktojnë artistë dhe bashkëpunëtorë për realizimin e projektit.

3. Shpenzimet administrative të një projekti artistik, të financuar nga fondi publik i artit skenik, nuk duhet të kalojnë 10 për qind të të gjithë vlerës së financimit.

Neni 24
Llojet e financimeve nga Qendra Kombëtare e Artit Skenik

Institucioni publik vendor i artit skenik, personi fizik apo juridik, privat, vendas ose i huaj, gëzon të drejtën të kërkojë nga Qendra Kombëtare e Artit Skenik financim, të pjesshëm ose të plotë, për një projekt skenik afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër.

Përcaktimet për këto lloj projektesh miratohen nga bordi artistik i QKAS-së.

Neni 25
Të drejtat pasurore për veprën e realizuar nga subjekti privat i artit skenik

Pasi ka shlyer detyrimet, që burojnë nga financimi, parashikuar në kontratën me Qendrën Kombëtare të Artit Skenik, subjekti përfitues i fondit, me statusin e institucionit publik vendor të artit skenik, personi fizik apo juridik, privat, vendas ose i huaj, gëzon të drejtën pasurore dhe jopasurore dhe të përdorimit të lirë të veprës teatrore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

KREU V
INSTITUCIONET PUBLIKE VENDORE TË ARTIT SKENIK

Neni 26
Institucionet publike vendore të artit skenik dhe statusi i tyre

1. Institucionet publike vendore të artit skenik janë institucione buxhetore, që krijohen ose shndërrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji, me nismën, vullnetin e pushtetit vendor dhe janë në varësi të njësisë së pushtetit vendor.

2. Statuti i institucionit publik vendor të artit skenik propozohet nga bordi artistik dhe miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

3. Përbërja e bordit artistik të institucionit publik vendor miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Anëtarët e bordit kanë mandat 3-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

4. Institucioni publik vendor i artit skenik e ka selinë në njësinë administrative vendore.

Neni 27
Burimet e financimit të institucioneve publike vendore të artit skenik

Burimet e financimit të institucionit publik vendor të artit skenik sigurohen nga:
a) financime nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor për shpenzimet administrative;
b) buxheti i pushtetit vendor për kulturën;
c) të ardhurat e siguruara nga projektet fituese në Qendrën Kombëtare të Artit Skenik;
ç) të ardhurat nga shitja e veprës skenike;
d) të ardhurat nga biletat, shërbimet që institucioni u bën të tretëve;
dh) sponsorizimet e donacionet;
e) të ardhura të tjera të ligjshme.

Neni 28
Zgjedhja e titullarit

Titullari i institucionit publik vendor të artit skenik emërohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe përzgjidhet ndërmjet dy kandidaturave të propozuara nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Procedurat e emërimit të tij përcaktohen në statut, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 29
Marrëdhëniet juridike të punës

Marrëdhëniet juridike të punës në institucionin publik vendor të artit skenik rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe me aktet nënligjore, statutin dhe rregulloren e brendshme.

Neni 30
Teatri metropolitan

1. Me "Teatër metropolitan" kuptohet statusi i veçantë, që i jepet një institucioni publik vendor të artit skenik në bazë të historikut, vlerave të larta artistike dhe kontributit të dhënë në kulturën kombëtare.
2. Procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies së statusit "Teatër metropolitan" përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI
SUBJEKTET PRIVATE TË ARTIT SKENIK

Neni 31
Subjektet e artit skenik privat

1. Subjektet e artit skenik privat funksionojnë në mbështetje të ligjeve nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".
2. Subjektet e artit skenik privat detyrohen të regjistrohen në QKAS dhe në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, në mënyrë që të përfitojnë financime për projekte private skenike nga fondi publik i artit skenik.

KREU VII
TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË CILËSISË ARTISTIKE

Neni 32
Masa dhe kriteret e shpërblimit

1. Masa e shpërblimit të vlerës artistike në artin skenik dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kushtet, kriteret dhe masa e shpërblimit për rezultate të larta, të arritura në konkurrime ndërkombëtare në artin skenik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

Teatri Kombëtar për Fëmijë bashkohet me Qendrën Kombëtare Kulturore të Fëmijëve dhe krijohet institucioni publik qendror "Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë".

Neni 34

Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit bashkohet me Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe krijohet "Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor".

Neni 35

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, 10, 16, 18, 30 e 32.

2. Kryeministri miraton brenda 6 muajve, në bazë të propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve strukturën dhe organikën e Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 36
Shfuqizimet

Ligji nr.8578, datë 10.2.2000 "Për teatrin" dhe të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5117, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1300**
4.	**PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)……..….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)……..….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR…….**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET……....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)…….....**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE…….....**	**500**

Hyri në shtyp më 22.11.2006
Doli nga shtypi më 24.11.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë